



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2512 prot.

Tiranë, më 06.06.2024

Lënda: Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2024

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR
Prof. Bektash MEMA, Rektor

I nderuar zoti Rektor,

Nëpërmjet kësaj letre, dëshiroj t'iu informoj për një nga iniciativat e përvitshme të Bankës së Shqipërisë dedikuar studentëve, konkursi "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2024".

Kriteret kryesore të pjesëmarrjes në këtë konkurs janë:

- Studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit;
- Nivel universitar ose pasuniversitar;
- Të kenë përfunduar studimet gjatë periudhës tetor 2023 – tetor 2024;
- Tema e diplomës mbi çështje të lidhura me integrimin dhe zhvillimin ekonomik, ekonomiksin monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar, etj.

Tre temat fituese përzgjidhen nga një komision i posaçëm shkencor i ngritur pranë Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim, ndërsa shpallja e tyre bëhet në një aktivitet tradicional në ambientet tona.

Banka e Shqipërisë fton të gjithë studentët shqiptarë në Shqipëri dhe mbarë botën të bëhen pjesë e këtij konkursi i cili kurorëzon përpjekjet më të arrira në fushën kërkimore shkencore.

Në këtë kuadër, do ta vlerësonim shumë ndihmën tuaj për të informuar pedagogët dhe studentët duke mundësuar ekspozimin e posterave bashkëlidhur si dhe njoftimin në rrjetet sociale të universitetit tuaj.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Sinqerisht,

GUVERNATOR
Gent Sejko





BANKA E SHQIPËRISË

2024

ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË

Banka e Shqipërisë fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkursin e hapur "Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2024", i dedikuar për studentët shqiptarë të diplomuar gjatë periudhës tetor 2023 – tetor 2024, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në një nga çështjet e ekonomisë monetare e ndërkombëtare, stabilitetit financiar, çështje të integritetit ekonomik të vendeve të Ballkanit në Evropë, politika monetare dhe politikat makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë, politika fiskale dhe roli i tyre në ekonomi, sistemi bankar shqiptar, sjelljet e individëve dhe firmave në Shqipëri, si dhe aspekte të ekonomisë në përgjithësi.

Afati i fundit i dorëzimit të temave: 31 tetor 2024



Çmimet

1. Çmimi i parë 250.000 lekë
2. Çmimi i dytë 200.000 lekë
3. Çmimi i tretë 150.000 lekë

Për më shumë informacion, klikoni në www.bankofalbania.org